



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.12.2023

Nr: 192

Ora: 10:45

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 97, DATË 12.12.2023

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.12.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Grupimi prej 20 (njëzet) deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë.

OBJEKT: Ankim kundër vendimit të "KQZ" për rrëzimin e kërkesës së Koalicionit "Bashkë Fitojmë" për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari.", në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e

Shqipërisë”, datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në zbatim të nenit 129 e vijues të Kodit Zgjedhor në seancën paraprake të datës 18.12.2023 mori në shqyrtim plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore të paraqitur nga një grup i përbërë nga 20 (njëzet) deputetë të Kuvendit të Shqipërisë të depozituar pranë KQZ-së, e cila është regjistruar në regjistrin e ankimeve, me nr. 97 regj., datë 12.12.2023.

KAS pavarësisht faktit se pala ankimuese nuk ishte prezent në këtë seancë megjithëse rezultoi të kishte dijeni rregullisht për zhvillimin e saj, vijoi me verifikimin e elementët e formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore në fjalë, duke marrë në konsideratë këto

Rrethana të çështjes:

1. Në bazë të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati/Kryetar Bashkie”.
2. Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, z. Kreshnik Riza Hajdari, në cilësinë e kandidat për kryetar të Bashkisë Kuçovë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ka depozituar në KQZ më datë 02.04.2023, formularin e vetëdeklarimit. Ky formular është regjistruar nga KQZ-ja me numër unik BR-PS-17366.
3. KQZ ka bërë verifikimin “prima facie” të formularit:

- Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për gjendjen gjyqësore të z. Kreshnik Hajdari. Në përgjigje të kësaj kërkesë DPB-ja ka konfirmuar se ky subjekt rezulton i padënuar penalisht.
- Po nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, KQZ-ja ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) në lidhje me gjeneralitetet e subjektit vetëdeklarues. Në përgjigje të kësaj kërkesë DPGJC konfirmon se subjekti vetëdeklarues, z. Kreshnik Riza Hajdari, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- Verifikoi të dhënat që përmban formulari i vetëdeklarimit dhe rezulton se nuk ka të dhëna për shkaqe të cilat sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zotit Kreshnik Hajdari do t’i ndalohej të kandidonte për kryetar bashkie.

4. Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” me anë të shkresës nr. 220, datë 04.04.2023, ka informuar KQZ-në se z. Kreshnik Hajdari është dënuar penalisht në shtetin grek.
5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4100 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të të dhënave, të pasqyruara ose jo në formularin e vetëdeklarimit, kur ato lidhen me një juridiksion penal të huaj.
6. Me shkresën nr. 601/35 prot., datë 02.11.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Kreshnik Riza Hajdari”. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së të gjitha verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në përcaktimet e pikës 3, shkronja “ç”, kreu III, dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari.

7. Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 679, datë 4.7.2023, i ka dhënë mandatin z. Kreshnik Hajdari si kryetar i Bashkisë Kuçovë.
8. Në seancën publike të KQZ-së të datës 14.11.2023 për vlerësimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, z. Kreshnik Hajdari, tashmë kryetar i Bashkisë Kuçovë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 816, datë 14.11.2023 “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, vendosi konstatimin se z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të Kryetarit.

Në konsideratë të sa më sipër, **KAS-i**

VËREN SE:

1. Pavarësisht të metave nga pikpamja e elementëve formalë të ankimit, I cili në kundërshtim me sa kërkohet në shkronjës “b”, pika 1 të nenit 126 të Kodit Zgjedhor, nuk ka referuar numrin dhe datën e aktit/vendimit që ankimohet, nga vlerësimi në tërësi I përmbajtjes të materialit ankimor, KAS konkludon se qëllimi I ankimuesve është të kundërshtojnë vendimi nr. 816, datë 14.11.2023 të KSHZ “Për shqyrtimin e e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar I bashkisë Kucovë, I propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë” me anë të të cilit është vendosur “Konstatimi se z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar I bashkisë Kucovë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të kryetarit.”
2. Në referim të parashikimeve të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (b) *legjitimitimin e ankuesit*. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese e cila ngre një pretendim, dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi. Pra, që ankimi të shqyrtohet në themel nga ana e KAS, duhet që ankuesi të gëzojë legjitimitet aktiv në ngritjen e këtij ankimi. Në këtë kontekst, KAS duhet së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv të ankuesit.

3. E drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme.

4. Që kërkesa ankimore të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore:

a) interesi i ligjshëm;

b) legjitimiteti për të vepruar.

Interesi i ligjshëm, sipas arsytimit të vendimit nr. 12, datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi. Interesi i ligjshëm i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të cënuar.

5. Në vlerësim të rrethanave të faktit, në procedimin administrativ të cilit I përket vendimmarrja e Komisionerit (vendimi nr. 816, datë 14.11.2023) që kundërshtohet, rezulton se grupi I deputetëve ankues nuk kanë qenë palë. Pra nuk janë ata që kanë kërkuar apo iniciuar para KQZ procesin e verifikimit të figurës të kryetarit të bashkisë Kuçovë z. Kreshnik Hajdari. Në këtë kuptim, përsa kohë grupi I deputetëve nuk ka qenë pjesë e procesit administrativ të zhvilluar nga Komisioneri, ai (grupi I deputetëve) nuk gëzon as legjitimitetin e nevojshëm për të ankimuar përpara KAS vendimin e komisionerit të marrë në përmbyllje të procesit administrative në fjalë sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 130 të Kodit Zgjedhor. Ankuesi nuk legjitimohet të kundërshtojë këtë vendim vetëm për faktin se gëzon cilësinë e deputetit të Kuvendit, pa provuar se preken interesa të tij të ligjshme. Ky është një nga kushtet themelore të legjitimitetit aktiv të palës që inicion një proces administrativ të shqyrtimit të një ankimi.

6. Referuar vendimmarrjeve analoge të meparshme të KAS, të drejtën e ankimit të vendimit nr. 816, datë 14.11.2023 të KSHZ-së, pra legjitimitetin aktiv, e gëzojnë partitë politike përbërëse të subjektit zgjedhor koalicionit “Bashkë Fitojmë”, I cili ka qenë subjekti që ka inicuaar procedurën administrative në fjalë duke informuar zyrtarisht KQZ me shkresën nr. 220, datë 04.04.2023 se z. Kreshnik Hajdari nuk ka deklaruar faktin se është denuar penalisht në shtetin grek.

7. Në këto kushte, në vlerësimin e KAS, ankimuesve nuk u është shkelur ndonjë e drejtë dhe as cënuar interesi i ligjshëm nga vendimmarrja e KSHZ. Për pasojë ata nuk legjitimohen në kundërshtimin e vendimit nr. 816, datë 14.11.2023 të KSHZ-së dhe për rrjedhojë kërkesa ankimore nr. 97 nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe nenit 129, pika 3 shkronja “b” dhe nenit 130 pika “b” Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 97, datë 12.12.2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1, të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

U shpall sot, më datë 18.12.2023.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar